



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ETEAM" Sh.P.K. të datës 22.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave-Llot 2" me nr. të prokurimit 616-25-7069-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ETEAM" Sh.P.K. të datës 22.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave-Llot 2" me nr. të prokurimit 616-25-7069-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ETEAM" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 22.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave-Llot 2" me nr. të prokurimit 616-25-7069-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Pajisjet e panevojshme, që nuk janë të lidhura me natyrën dhe përmasat e projektit janë si në vijim: Kamion kiper min. Peshë 40t; – Kamion kiper min. Peshë 30 t; –Gjysëmrimorkio per bartjen e automjeteve të rëndë min.90t; Makinë ngjeshese cilindër me dhembëza min peshë 21t; – Kamion kiper për transport të asfaltit të gatshëm min peshë 32t".

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se pajisjet për të cilat bëhet fjalë janë të gjitha pajisje absolutisht të domosdoshme për të siguruar realizimin e këtij projekti në mënyrë efikase dhe efektive. Vlen të thuhet që lagja Kodra e Trimave është një nga lagjet kryesore të Kryeqytetit. Prandaj ndërtimi i rrugëve në këtë lagje është padyshim një nga projektet kryesore të cilat synon të realizoj Komuna e Prishtinës. Duke marrë parasysh numrin e madh të makinave dhe qytetarëve që i frekuentojnë këto rrugë, është e domosdoshme që projekti të realizohet në afat shumë të shpejt, por me cilësi shumë të lartë. Për të arritur këtë qëllim padyshim se kërkohet makineria e përshtatshme.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.